

Cfarë e bën Europën një treg tërheqës për erëzat dhe bimët medicinale?

Europa është një nga importuesit kryesorë të erëzave dhe bimëve medicinale në botë. Erëzat dhe bimët medicinale janë përbërës të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në industrinë ushqimore dhe atë të pijeve në Europë. Nëpërmjet përdorimeve të ndryshme, ky sektor siguron një rritje afat gjatë dhe mundësi të ndryshme. Zgjerimi i tregut European për erëzat dhe bimët nxitet nga funksionaliteti, rritja e ushqimeve dhe pijeve etnike si dhe nga reduktimi nga industria e kripës dhe sheqerit.

Një treg i madh European që tregon rritje afat gjatë

Europa është një nga rajonet kryesore të importit të erëzave dhe bimëve medicinale, e cila llogaritet si një e katërta e importeve globale. Në 2021, Azia ishte importuesja kryesore e erëzave dhe bimëve medicinale duke zënë 45% të tregut total, e ndjekur nga Europa me 28%, Amerika e veriut (SHBA & Kanada) me 17%, Afrika me 4%, Amerika latine dhe Karaibet me 4% dhe Oqeania me 2%.

Europa mund të mos jetë tregu më i madh për erëzat dhe bimët medicinale, por është shumë interesante për vendet në zhvillim. Më shumë se 95% e importeve që vijnë nga jashtë Europës vijnë nga vendet në zhvillim. Varësia e fortë nga importet e erëzave nga vendet në zhvillim gjithashtu tregon se pothuajse e gjithë tregtia brenda Europës konsiston në ri-eksportimin e erëzave që erdhën fillimisht nga vende në zhvillim. Në rastin e bimëve medicinale, megjithatë, një pjesë e madhe e produkteve të konsumuara në Europë prodhohen gjithashtu në vend.

Gjithashtu, çmimet mesatare të importit në Europë janë shumë më të larta se në shumë rajone të tjera. Për shembull, çmimi mesatar i erëzave të importuara në Europë është pothuajse dyfish më i lartë se çmimet në Azi. Kjo e bën Europën një treg të synuar interesant për eksportuesit nga vendet në zhvillim, pavarësisht nga luhatjet e tregut që ndodhin për produkte të caktuara për shkak të ndryshimit të kërkesës.

Pas një rritje të fuqishme në 2015 – 2017, tregu ra në 2018 dhe 2019. Megjithatë, trendi pozitiv i parë në 2015 – 2017, kur vlerat e importit të erëzave dhe bimëve medicinale u rritën çdo vit, u shkaktua vetën në disa erëza. Veçanërisht, vanilja pati një ndikim të konsiderueshëm në rritje.

Ndërmjet vitit 2019 – 2021, tregu European pati një rritje tjetër, veçanërisht në importet nga vendet në zhvillim. Importet e erëzave dhe bimëve medicinale në këtë

periudhë u rritën me një rang vjetor në 9.0%, duke arritur 1.8 bilion Euro dhe duke zënë 60% të importeve në Europë.

Ndërkohë që importet në Europë supozohen të vazhdojnë rritjen në rang të moderuar përgjatë vitit të ardhshëm, ato pritet të qëndrojnë më të ulta se në rajonet e tjera në botë, siç janë Azia jugore dhe juglindore, ku ekonomia dhe rritja e tregut kanë qenë mesatarisht shumë të larta në dekadën e kaluar.

Industria e gjerë dhe dinamike Europiane e ushqimit dhe e pijeve

Erëzat dhe bimët medicinale janë përbërës të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në industrinë Europiane të ushqimit dhe pijeve. Sipas Food and Drink Europe, [ka një qarkullim prej afërsisht 1.1 trilion Euro](#). Ndërmjet vitit 2013 – 2019, qarkulimi i industrisë ushqimore Europiane u luhat. Në fund të vitit 2021 industria tregoi shenja rritjeje përsëri, [me një qarkullim në rritje prej 3.3%](#) në tremujorin e katërt të 2021 krahasuar me tremujorin parardhës.

Franca ka industrinë më të madhe të ushqimit dhe pijeve në Europë, duke zënë rreth 19% të qarkullimit total; Gjermania zë 17%; Italia 13%; Spanja 11%; Hollaamda 7%; Polonia 5% dhe Belgjika 5%.

Brenda industrisë udhqimore, segmentet e produkteve të mishit (piperi, speci djegës, produktet picante, hurdha e thatë, safran, cumin, trumza, rozmarina, qepa e thatë etj), produkte buke dhe pluhur (kanellë, kardamon, karafil, arrëmoskat, xhinxher etj) pijet (xhinxher, trumëz, sherebelë, kurkuma, koper etj), fruta dhe perime të përpunuara dhe produktet e detit janë veçanërisht të rëndësishme për erëzat dhe bimët mjeksore. Këto segmente përbëjnë më shumë se gjysmën e totalit të industrisë së ushqimit.

Rritja e industrisë Europiane të ushqimit dhe pijeve ka një impakt të rëndësishëm në rritjen e kërkesave për erëza dhe bimë medicinale. Kërkesa parashikohet të vazhdojë rritjen në mënyrë të moderuar në 3-5 vitet në vazhdim, duke ndjekur rritjen e industrisë.

Disa nga trendet që nxisin përdorimin e erëzave dhe bimëve medicinale në industrinë ushqimore Europiane janë:

Funksionaliteti: rritja e kërkesës për ushqime dhe pije që promovojnë shëndetin, si sistemi trtes apo shendeti ne pergjithesi. Shoqata Europiane e Erëzave (ESA) ka

publikuar disa studime në websitin e saj që tregojnë perfitimet shëndetësore nga erzat e ndryshme ([highlighting the health benefits of spices](#)).

- **Ushqim dhe pije etnike:** rritja dhe më shumë e njohurive për gatime specifike. Parashikimi për rritjen e përdorimit të kuzhines aziatike, Indoneziane, Malajzeze dhe Filipinase. Gjithashtu, përdorimi i erëzave miks të përdorura në kuzhinën e Lindjes së Mesme si za'atar, baharat, berbere, zhug, chermoula and ras-el-hanout.
- **Zëvendësuesit e kripës dhe sheqerit:** në shumë vende, po ndërmerren veprime për të reduktuar marrjen dietike të kripës së gjellës (natriumit) dhe sheqerit të përpunuar. BE ndërmerr veprime politike që influencojnë industrinë, siç janë [Salt Campaign](#) dhe të rehat mbi rregulloren e BE për të reduktuar impaktin e mundshëm të sheqerit në shëndetin e njerzve ([updates in EU regulation to reduce the potential impact of sugars on human health](#)), mbështetur shkencërisht nga [European Food Safety Authority](#).

Gjermania: tregu më i madh i erëzave në Europë

Sot Gjermania është importuesi më i madh i erëzave dhe bimëve medicinale, me një vlerë importi prej €592 milion ose 154 mijë ton në 2021, që përbën 21% të totalit të importeve në Europë. Kategoritë kryesore të importuara në Gjermani janë: piperi dhe speci djegës (33%), xhinxhër, shafran, kurkuma dhe të tjera (32%), dhe vanilja (14%).

Rreth 78% e importeve në Gjermani vijnë direkt nga vendet në zhvillim. Kina është furnizuesi më i madh i Gjermanisë në terma vlere, duke qenë furnizuesi kryesor i xhinxherit (kryesisht të papërpunuara dhe të plota) dhe specit djegës (të plota, të coptuara dhe të bluara). Importet gjermane nga Kina mbuluan 20% të totalit të importeve në vitin 2021. Furnizuesi i dytë në 2021 ishte Madagaskari (12%) kryesisht me furnizimin me vanilje, dhe të sasive më të vogla të kanellës dhe karafilit.

Furnizues të tjerë të rëndësishëm të vendeve në zhvillim për erëzat dhe bimët medicinale në Gjermani janë Vietnami (8.8%) dhe Brazili (8.4%), kryesisht duke furnizuar me piper dhe speci djegës, Indonezia (6.3%), dhe India (5.3%). Brenda Europës, Holanda është një riekportues i rëndësishëm në Gjermani duke llogaritur 6.5% të importeve gjermane. Kategoria kryesore e produktit eksportuar nga Holanda në Gjermani është erëzat miks, e cila tregon që industria e përpunimit të erëzave Holandeze është një konkurrencë të rëndësishme për furnitorët në këtë kategori.

Mes vendeve furniuese të Gjermanisë që performuan fuqishëm në 2017 – 2021 janë Guatemala dhe Peruja të cilat regjistruan shifra rritje të dyfishuara. Guatemalsi si furnizuesja kryesore e kardamonit pati një rritje vjetore prej +24%, dhe Peruja, furnizuesi kryesor i xhinxherit pati një rritje vjetore prej +11%. Brazili (-9.4%), Indonezia (-8.2%) and Madagaskar (-7.3%) furnitorët e tyre patën një ulje drastike në këtë periudhë.

Gjermania është një nga vendet lider në tregun global të erëzave. Porti i Hamburgut ka fasilitetet më të mira në botë për transportin dhe magazinimin e erëzave.

Gjermania është gjithashtu shtëpia e kompanive të përpunimit më të mëdha në botë të cilat gjenerojnë në botë të cilat gjenerojnë kërkesa të larta për erëza dhe bimë medicinale. Kompani të mëdha të erëzave të përfshira në bluarjen, paketimin dhe përpunime të tjera të tilla si: [Fuchs](#), [Husarich](#), [Hamburger Gewürz-Mühle](#) dhe [ENES Gewürze](#), kanë një prezencë të fuqishme në tregun gjerman dhe shpesh importojnë erëza direkt nga vendet në zhvillim.

Kompani të tjera të mëdha të përpunimit, të tilla si: [Nestlé](#), [Kraft Foods](#) dhe [Hela](#), të cilat gjithashtu janë shumë prezente në Gjermani, në dekadën e fundit kanë kaluar gjithashtu në importe të drejtpërdrejta nga vendet në zhvillim, por ende priren të mbështeten shumë tek tregtarët e erëzave për furnizimin e tyre. Këto kompani ndihmojnë që industria e ushimit dhe pijeve të bëhet sektori i katërt më i madh i industrisë në Gjermani.

Ekzistojnë disa tregtarë të ndryshëm të erëzave në vend të cilët bëjnë lidhjen mes furnizuesve dhe industrivetë fundit të zinxhirit të vlerës së produktit të tilla si [Worlée](#), [Schuco](#) dhe [AKO The Spice Company](#). Shumë kompani gjermane të erëzave mund të gjehen në website e [German Spice Association](#).

Tregu organik gjerman është tregu më i madh dhe një nga më të zhvilluarit në Europë e që vazhdon të rritet. Në vitin 2020 tregu i ushqimit organik në Gjermani u rrit me më shumë se 20% krahasuar me vitin 2019, duke arritur 15 bilion €. Kjo është afërsisht 30% e tregut organik në Europë. Rritja pritet të rritet në vitet në vazhdim, ndonëse me një rritëm më të ulët. Në Gjermani janë disa kompani të ndryshme erëzash që merren me erëza dhe bimë medicinale të çertifikuara organike, si [Spice Bar](#), [Delidia](#), [Herbaria](#), [Hartkorn](#) dhe [Grünberg](#).

Spanja: një treg i fuqishëm për piperin dhe shafranin

Spanja është një treg unik mes importuesve më të mëdhenj të erëzave në Europë. Erëzat kryesore që tregtohen në Spanjë janë të ndryshme nga ato që tregtohen në

vendet europiane dhe po ashtu janë vendet furnizuese kryesore të saj. Të ardhurat nga importet direkte nga vendet në zhvillim është e lartë, në 85%. Furnizuesit kryesorë të spanjës janë Kina, Irani, Peruja, Vietnami, India dhe Brazili.

Spanja është prodhuesi dhe përpunuesi më i madh i specit në botë me shumë lloje të ndryshme të specit të thatë të cilat përdoren gjerësisht si përbërës ngjyruës dhe aromatizues në përgatitjet ushqimore. Për shkak të sasive të mëdha dhe në rritje të importit të specit, Spanja importoi nga vendet në zhvillim një total prej 195 milion € në 2020. Spanja importoi më shumë nga vendet në zhvillim se sa Mbretëria e Bashkuar.

Kina shquhet për furnizimet e saj të piperit në Spanjë. Ky vend mbulon 41% të importeve totale të Spanjës. Një furnizues tjetër i rëndësishëm i specit është Peruja me 7.8% të importeve në Spanjë në 2021. Furnizimet nga Peruja kanë mbetur mjaft të qëndrueshme që nga viti 2017, ndërsa furnizuesit nga Kina janë rritur fuqishëm me një normë vjetore prej 10%.

Shafrani është produkti i dytë më i rëndësishëm mes importeve të erëzave në Spanjë. Furnizuesi i tij i shafranit pothuajse ekskluziv është Irani. Shafrani përdoret nga kompani të përpunimit si përbërës ngjyruës dhe është një ingredient kyç në gatimin e orizit dhe recetave të ndryshme të kuzhinës tipike spanjolle.

Lloje të tjera të erëzave që përfaqësojnë një pjesë të madhe të importit të erëzave në Spanjë përfshijnë xhinxherin, piperi, kanella dhe shafran.

Në Spanjë janë rreth 110 kompani të specializuara në tregtimin dhe prodhimin të erëzave. Gjithashtu Spanja ka një [association for spice processors and packers \(AEC\)](#), e cila përbëhet nga 20 anëtarëmqë sunojnë industrinë e shitjes me pakicë dhe të ushqimit. Vendi ka një industri ushqimore vërtetë dinamike, e fokusuar fuqimisht në krijimin e produkteve ushqimore dhe erëzave.

Polonia: lider në Europën Lindore

Polonia është mes gjashtë importuesve më të mëdhenj të erëzave dhe bimëve medicinale në Europë. Importet nga vendet në zhvillim janë rritur me shpejtësi duke zënë 63% të importeve totale të erëzave dhe bimëve medicinale dhe afërsisht 80 milion € në 2021.

Vietnami (16% të importeve totale në 2021), Kina (9.5%) dhe Indonezia (5.9%) janë furnizuesit kryesor të Polonisë. Eksportet e Kinës në Poloni konsistojnë kryesisht në

në spec djeges dhe xhinxher, ndërsa Vietnami kryesisht furnizon me piper. Furnizimet e Indonezisë konsistojnë kryesisht në kanellë dhe arrëmoskat. India (5.4%) dhe Madagaskari janë gjithashtu furnizues të rëndësishëm të erëzave dhe bimëve medicinale në Poloni.

Në Europë, Gjermania dhe Holanda gjithashtu furnizojnë me erëza dhe bimë medicinale Poloninë. Në vitin 2021, këto dy vende mbulluan afërsisht një të katërtën e totalit të importeve të Polonisë.

Importet e erëzave në Poloni bëhen nga tregtarë polakë si [Rolmex](#) dhe [TomPol](#), dhe nga kompania gjermane e prodhimit të erëzave në Poloni, më e njohura [AVO](#). E fundit por jo më pak e rëndësishmja, Polonia është shtëpia e prodhimit të fasilitetve të kompanisë angleze [AB World Foods](#), kompania mëmë e dy markave kryesore europiane të salcave dhe pastave aziatike Blue Dragon dhe Pataks. Ndërsa AB World Foods ka gjithashtu fasilitete prodhuese në Mbretka gjithashtu fasilitete prodhuese në Mbretërinë e Bashkuar, presupozohet se mbi gjysma e prodhimit për kontinentin European vjen nga Polonia.

Burimi: Qendra për Promovimin e Importeve nga vendet në zhvillim (CBI)